



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS SKENDERAJ

Numri i lëndës: 2019:243270

Datë: 21.11.2019

Numri i dokumentit: 00666456

P.nr. 486/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, DEGA SKENDERAJ- me gjyqtarin e vetëm gjykues Mentor Hajraj dhe me procesmbajtësen Aferdita Isufi, në çështjen penale kundër të akuzuarit Sh. (B) K nga fsha. ... komuna ... ku edhe banon, për shkak të veprës penale – Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armeve nga neni 374 par.1 të KPRK-ës i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë Dep. i Përgjithshëm PP.II.nr.1647/2018, e dt.07.10.2019, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me dt.19.11.2019, në të cilin ishin prezent prokurori i Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, Sllobodan Bakiq, dhe i akuzuari Sh.K, me dt.20.11.2019, e mori dhe me pas publikisht e shpalli, ndërsa me dt.21.11.2019, e përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **Sh.K**, i biri i B. dhe B. e vajzërisë B., i lindur me dt., në fshatin ..., komuna e ...i, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, ka të kryer shkollën e mesme, gjendjes së dobët ekonomike, jo në marrëdhënie pune, me numër personal: ...

Ë S H T Ë F A J T O R

SEPSE: Që deri me datën 15.02.2018 rreth orës 11:40 minuta në rrugën “...” në Skenderaj, edhe pse ka qene i vetëdijshëm të kuptojë rëndësinë e veprës së tij dhe të drejtoje veprimet e tij, i vetëdijshëm për ndalesat e veprimeve të tij, ka dashur të kryej të njëjtën vepër, kështu që ka mbajtur në posedim arme zjarri dhe municion e cila është e ndaluar për përdorim për qytetar sipas Ligjit mbi Armët të R. Kosovës (05/L-022) dhe atë një pistoletë e tipit “Pietro Beretta” modeli 1934 me kalibër 7,65 mm, 1 karikator dhe 3 plumba të kalibrit 7,65 x 17 mm, të cilat policet zyrtar të SP-Skenderaj me rastin e bastisjes së shtëpisë lidhur me një rast tjetër i kanë gjetur tek i pandehuri, e pastaj arma e lartcekur është konfiskuar.

Me këtë ka kryer vepër penale – Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armeve nga neni 374 par.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të se njëjtës dispozite ligjore si dhe nenit 41, 46 dhe 73 të KPRK-së, dhe nenit 365, 450, 453 dhe 463 të KPP-së, të akuzuarin, e:

G J Y K O N D Ë N I M M E G J O B Ë

Të akuzuarit gjykata i shqipton dënim me gjobë në lartësi prej **300 (treqind) euro**, të cilin dënim është i obliguar ta paguaj në afatin prej 30 ditësh prej ditës së plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i akuzuari dënimin e shqiptuar me gjobë nuk e paguan në afatin e përcaktuar nga gjykata atëherë ky dënim do t'i zëvendësohet në bazë të nenit 46 par.3 të KPRK-së.

Obligohet i akuzuari që të paguaj shpenzimet e procedurës penale në shumë prej 20 njëzet euro, në emër të paushallit gjyqësor obligohet të paguaj shumën prej 10 dhjet euro, dhe në emër të Fondit për kompensimin e viktimave shumen prej 30 euro, të cilat është i obliguar që t'i paguaj në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Pala të dëmtuar sipas aktakuzës nuk pati, andaj për realizimin e kërkesës pasurore juridike gjykata nuk vendosi fare.

Gjykata të akuzuarit krahas dënimit kryesor duke u bazuar në dispozitën ligjore nga neni 69 par.1 lidhur me nenin 374 par.3 të KPRK-së i shqipton:

Dënimin plotësuese-Marrja e sendit

Urdhërohet konfiskimi i përhershëm i armës-një pistoletë të tipit "Pietro Beretta" modeli 1934 me kalibër 7,65 mm, 1 karikator dhe 3 plumba të kalibrit 7,65 x 17 mm, e cila armë duhet të shkatërrohet nga Policia e Kosovës pasi ky aktgjykim të marr formën e prerë, nëse vërtetohet se e njëjta nuk është përdorur në ndonjë rast tjetër të hapur.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Përgjithshëm me aktakuzën e saj PP.II.nr.1647/2018, e dt.07.10.2019, e ka akuzuar Sh.K nga fshati ..., komuna e ..., për shkak të veprës penale- Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armeve nga neni 374 par.1 të KPRK-së.

Gjykata në këtë çështje penale me dt.19.11.2019, e ka mbajtur shqyrtimin fillestar në të cilin shqyrtim të akuzuarin e ka njoftuar me të drejtat e tij procedurale, i njëjti ka deklaruar se i ka kuptuar të drejtat e tij dhe se në këtë çështje penale dëshiron të mbrohet vete.

Pas leximit të aktakuzës, gjykata të akuzuarin e ka njoftuar hollësisht me pasojat e pranimi të fajësisë, i njëjti ka deklaruar se i ka kuptuar pasojat e pranimi të fajësisë e me pas u deklarua se e pranon fajësinë në tërësi për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohej sipas aktakuzës, njëherësh shprehu keqardhje për rastin që i ka ndodhur, i

premtoi gjykatës së në të ardhmen do të jete me i kujdesshëm dhe nuk do t'i përsëris veprimet e tilla.

Pas pranimit të fajësisë nga i akuzuari, gjykata e kërkojë mendimin nga prokurori i shtetit, i cila me këtë rast deklaroi se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa imponime, ky pranim i fajësisë ka mbështetje në provat materiale që gjenden në shkresat e lëndës dhe i propozoj gjykatës që ta aprovoj këtë pranim fajësie nga i akuzuari.

Pas pranimit të fajësisë nga i akuzuari dhe pas marrjes së mendimit nga prokurori i shtetit, gjyqtari i vetëm gjykues në bazë të dispozitës ligjore nga neni 248 par. 4 të KPP-së, ka marrë vendim me të cilin e ka pranuar pranimin e fajësisë nga i akuzuari lidhur me veprën penale e cila i vihet në barrë sipas kësaj aktakuze ngase konsideroj se pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare nga i akuzuari dhe se i njëjti i ka kuptuar pasojat e pranimit të fajësisë, i cili pranim është mbështetur në provat materiale të cilat gjenden në shkresat e kësaj lënde, dhe nuk ka zbatuar procedurën e provave por, ka vazhduar me shqiptimin e dënimit si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Gjendjen faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi gjykata e vërtetoi para se gjithash nga pranimi i fajësisë nga i akuzuari, pranim i cili ishte i vullnetshëm dhe i mbështetur në të gjitha pikat e aktakuzës, si dhe nga provat materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës në raport me të akuzuarin siç ishin: Deklarata e të pandehurit e dt.15.02.2018, Vërtetimi mbi konfiskimin e sendeve me nr. ... të dt.15.02.2018, si dhe nga vështrimi në foto dokumentacionin dhe te gjitha shkresat tjera të lëndës.

Në bazë të gjendjes faktike të pakontestueshme, gjykata vërteton se me veprimet inkriminuese të të akuzuarit përmbushen të gjitha elementet qenësore të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armeve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, ngase i njëjti deri me datën 15.02.2018 rreth orës 11:40 minuta në rrugën “...” në Skenderaj, edhe pse ka qene i vetëdijshëm të kuptojë rëndësin e veprës së tij dhe të drejtoje veprimet e tij, i vetëdijshëm për ndalesat e veprimeve të tij, ka dashur të kryej të njëjtën vepër, kështu që ka mbajtur në posedim arme zjarri dhe municion e cila është e ndaluar për përdorim për qytetar sipas Ligjit mbi Armët të R. Kosovës (05/L-022) dhe atë një pistoletë e tipit “Pietro Beretta” modeli 1934 me kalibër 7,65 mm, 1 karikator dhe 3 plumba të kalibrit 7,65 x 17 mm, të cilat policet zyrtar të SP-Skenderaj me rastin e bastisjen së shtëpisë lidhur me nje rast tjetër i kane gjetur tek i pandehuri, e pastaj arma e lartcekur është konfiskuar, për çka gjykata gjeti se i akuzuari në aspektin penal-juridik është përgjegjës dhe i shqiptojë dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin gjykata i pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara në nenin 73 të KPRK-së, e në rastin konkret për të akuzuarin si rrethanë lehtësuese gjeti faktin se i njëjti gjatë shqyrtimit fillestar e pranoi në tërësi fajësinë lidhur me aktakuzën e cila i vihej në barrë me çka gjykatës i ndihmojë në masë të madhe në vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike gjithashtu, rrethanë lehtësuese gjykata gjeti sjelljen e tij korrekte në gjykatë, ndërsa si rrethanë rënduese për të njëjtin gjykata gjeti mënyrën e kryerjes së veprës penale.

Andaj, gjykata duke u bazuar në rrethanat e cekura si më lartë të akuzuarit i shqiptojë dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se ky dënim është adekuat me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit dhe se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 të KPRK-së, që të parandalojë kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave të tilla penale, të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Gjykata të akuzuarit Sh.K krahas dënimit kryesor duke u bazuar në dispozitën ligjore nga neni 69 parag.1 lidhur me nenin 374 par.3 të KPRK-së i shqipton edhe -Dënimin plotësues-Marrjen e sendit, dhe pasi aktgjykimi të merr formën e prerë i merret: një pistoletë e tipit "Pietro Beretta" modeli 1934 me kalibër 7,65 mm, 1 karikator dhe 3 plumba të kalibrit 7,65 x 17 mm, e cila armë duhet të shkatërrohet nga Policia e Kosovës pasi ky aktgjykim të marr formën e prerë, nëse vërtetohet së e njëjta nuk është përdorur në ndonjë rast tjetër të hapur.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor, gjykata e mori në bazë të nenit 450 parag.1 dhe 2 pika 2. 6 lidhur me nenin 453 parag.1 dhe 2 të KPP-së.

Nga si u tha me lartë, e në mbështetje të nenin 365 të KPP-së, Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA SKENDERAJ
- Departamenti i Përgjithshëm -
P.nr.486/2019, dt. 21.11.2019

Procesmbajtësja
Aferdita Isufi

Gjyqtari i vetëm gjykues
Mentor Hajraj

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar paraqitja e ankesës në afatin prej 15 ditësh nga dita e pranimin të këtij aktgjykimi, përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.